

PKR.nr.399/12

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, gjykata e shkallës së parë penale, me trupin gjykues në përbërje prej gjyqtarëve profesionistë, Suzana Çerkini, kryetare, Afërdita Bytyqi dhe Arben Hoti, me pjesmarrje e sekretares juridike Ardita Azemi, në çështjen penale kundër të pandehurit G.V.nga fshati R. i R., Komuna L., për shkak të veprave penale Mbjtje në Pronësi, Kontroll, Posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK dhe Dëmtim i pasurisë së luajtshme nga neni 260 par 1 të KPK, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Publike të Qarkut, tani Themelore në Prishtinë PP.nr.35-2/2012 të datës 23.02.2012, pas shqyrtimit të hapur kryesor, të mbajtur me datë 24.10.2016, me praninë e prokurorit të shtetit Iliaz Beqiri dhe të akuzuarit G. V., me mbrojtësin sipas detyrës zyrtare, av. Sh.B., në të njëjtën datë, mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari G. V., nga i ati K., dhe e nëna N., e vajzërisë M., i lindur me *data e lindjes...* në fshatin R. i R., Komuna L., ku edhe jeton, i martuar, ka të kryer shkollën fillore dhe dy vjet të shkollës së mesme, punëtor në ndertimtari, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar,— shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me LNJ të RKS me numër personal *numër personal...*,

-I-**ËSHTË FAJTOR**

Sepse, me datë 08.01.2011 në një aheng familjar (fejesë e Vëllait), në fshatin R. i R., ka shtënë me armën e tipit AK-47 me nr. serik 1849, për të cilën armë nuk posedonte leje nga organi kompetent, andaj e njëjta edhe i është konfiskuar nga policia,

- me këtë ka kryer veprë penale Mbjtja në Pronësi, në kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 1 të KPK,

Andaj, gjykata, në bazë të neneve 6, 11, 15, 34, 35, 41, 42, 43, 44 par.1, 45, 54 par.2.7, 60, 64, 65,66, 67 par.1 pika 4 të KPK dhe neneve 326, 357, 359, 365 dhe 366 të KPP, i shqipton,

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që i cakton dënim burgimi në kohëzgjatje prej **1 (një) viti**, i cili nuk do të ekzekutohet në qoftë se në afat prej **2 (dy) vjetësh**, nuk do të kryej veprë të re penale, si dhe,

DËNIM PLOTËSUES

Konfiskohet: një pushkë automatike AK-47 me numër serik 1849 me një karikator, të precizuara në procesverbalin e dëshmisë Nr.2011 AH 0034 të datës 08.01.2011,

- Ndërsa komform nenit 363 par.1 nënpar.1.1 të KPP, për veprën penale dëmtim i pasurisë së luajtshme nga neni 260 par 1 të KPK,

-II-

REFUZOHET AKUZA

Sepse, në të njëjtën kohë dhe vend si nëdispozitivin nën në pikën I të aktzkauzës, nga predhat e shkrepura në ahengun familjar, një predhë e shkrepur nga arma e ka goditur dhe dëmtuar xhamin e përpariëm te veturës “Golf 2” me targë regjistrimi *numër i targave...*, pronë e M. B. nga fshati G., Komuna H. E., i cili në ato momente ishte rrugës duke u kthyer nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, Adem Jashari,

- me çka kishte për të kryer vepër penale dëmtim i pasurisë së luajtshme nga neni 260 par 1 të KPK,
- Për shkak se prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza, prë arsye se me datë 08.01.2015 ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale,

Obligohet i pandehuri që t’i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej **50 € (pesëdhjetë) euro**, në afat prej 15 ditësh, pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë,

A r s y e t i m

Prokuroria Publike e Qarkut, tani Themelore në Prishtinë me Aktakuzën PP.nr.35-2/2012 të datës 23.02.2012, ka akuzuar të pandehurin G. V., për shkak të veprave penale Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim ose shfrytëzim te paautorizuar të armëve nga neni 328 par 1 të KPK dhe Dëmtim i pasurisë së luajtshme nga neni 260 par. 1 të KPK dhe, njëherësh i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor, të pandehurin t’a shpall fajtor dhe t’a dënojë sipas ligjit.

Gjykata, duke vepruar sipas aktakuzës së lartshënuar në këtë çështje penale, të konfirmuar me datë 13.06.2016, ka mbajtur shqyrtim kryesor, në të cilin prokurori i shtetit fillimisht është tërhequr nga ndjekja penale për veprën penale dëmtim i pasurisë së luajtshme nga neni 260 par. 1 të KPK, ngase për këtë vepër penale tanimë ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale dhe atë me datë 08.01.2015.

Në vazhdim të shqyrtimit gjyqësor, i akuzuari G. V., në prani të mbrojtësit të tij, sipas detyrës zyrtare, av. Sh.B., duke qenë në dijeni të plotë për pasojat dhe përparësit e pranimit të fajsisë, si dhe pas

konsultimit të mjaftueshëm me të njëjtin, vullnetarisht deklaroi se e pranon në tërësi fajsinë për veprën penale Mbajtje në Pronësi, Kontroll, Posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par 1 të KPK, për çfarë edhe akuzohet.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. Sh.B., ka deklaruar se e mbështet pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij, meqë është konsultuar mjaftueshëm dhe pranimi nga i mbrojturi i tij është bërë vullnetarisht, andaj i ka propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit të merret si rrethanë lehtësuese pranimi i fajësisë, pendimi i të akuzuarit, dhe fakti se që nga ajo kohë nuk ka kryer asnjë veprë tjetër penale, fakt ky të cilin e ka pohuar edhe i akuzuari.

Prokurori i shtetit ka deklaruar se gjithashtu pajtohet me pranimin e fajësisë nga i akuzuari, pasi që është në përputhje me dispozitat e KPP.

Pas deklarimit të të akuzuarit se ndihet fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet dhe, pas marrjes edhe të mendimit të mbrojtësit të tij dhe prokurorit, gjykata me aktvendim ka aprovuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari, pasi që është bindur se i njëjti, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke qenë i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, pasi që pranimi mbështetet në faktet e çështjes që përmban akuza dhe në provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës.

Në vazhdim, prokurori i shtetit, në fjalën përfundimtare i propozoi gjykatës që të akuzuarin t'a shpall fajtor dhe t'a dënojë sipas ligjit, ngase nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, u vërtetua se ai ka kryer veprën penale që i vihet në barrë, andaj i propozoi gjykatës që me rastin e matjes së dënimit, faktin e pranimin të fajësisë t'a merr si rrethanë lehtësuese.

Gjykata, pas aprovimit të fajësisë së të akuzuarit dhe vlerësimit të rrethanave të rastit, konstatoi gjendjen e fakteve që i përmban akuza, nxjerri konkluzion të drejtë dhe të ligjshëm, se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë elementet e veprës penale që i vihet në barrë, të përshkruar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, andaj pasi që më parë gjeti se i akuzuari është penalisht përgjegjës, të njëjtin e shpalli fajtor për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK dhe, i shqiptoi dënimin e paraparë ligjor.

Me rastin e përcaktimit të vendimit mbi dënimin për të akuzuarin, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara ligjore, si ato lehtësuese dhe rënduese, që ndikojnë në llojin dhe lartësisë së dënimit, si rrethanë veqanërisht lehtësuese pati parasysh pranimin e fajësisë, moshën e re të akuzuarit, pendimin e tij dhe faktin se asnjëherë tjetër nuk ka kryer veprë penale, siç edhe vërtetohet nga baza e shënimeve të kësaj gjykate, ndërsa gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë veqanërisht rënduese, prandaj të akuzuarin e dënoi me dënim të zbutur me burgim, të cilin ia kushtëzoi për periudhë të caktuar verifikuese, me bindje se edhe dënimi i shqiptuar, do t'i përgjigjet peshës së veprës penale, si dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarit, se me dënimin e shqiptuar ndaj të njëjtit do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 34 të KPK dhe se, i pandehuri në të ardhmen nuk do të përsërisë veprë tjetër penale të natyrës së tillë apo të ngjashme.

Vendimin për konfiskimin e sendeve, të armës dhe gjësendeve të tjera, të mbajtura, përkatësisht të përdorura në mënyrë të paautorizuar, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 62 të KPK lidhur me nenin 328 par.3 të KPK.

Vendimin për shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, gjykata e mori në bazë të nenit 453 par.1 të KPP.

Nga sa u tha më lartë dhe në bazë të nenit 365 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/ DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.399/12, me datë 24.10.2016**

**Sekretarja juridike
Ardita Azemi**

**Kryetarja e trupit gjykues,
Suzana Çerkini**

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.